25. Procedura e ankesës 1. Cdo Operatori Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Njoftimin e Kontratës, Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik

që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti/enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti /enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Grafiku i realizimit të punimeve

Shtojca 7: Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve

Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit

Shtojca 10: Preventivat e Punimeve

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.

Shtojca 12 - Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 13 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit) .

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
(Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Vlerësimit;
 - 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 - 6. Preventivin e çmimeve
 - 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
 - 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 - 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula**

Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit /entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj: Sipas dokumenteve bashkelidhur DT

Specifikimi i Materialeve: Sipas dokumenteve bashkelidhur DT

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Sipas dokumenteve bashkelidhur DT

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: sipas dokumentit Grafiku i punimeve bashkelidhur dokumentave te tenderit dhe ne perputhje me piken 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Pika 3

1	2	3. Afati i realizimit									
Nr	Përshkrim i i Punëve	Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Muaji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Muaji 5	Java 6/Muaji 6	Java 7/Muaji 7	Java 8/Muaji 8	Java 9/Muaji 9	Java 10/Muaji 10
1.											
2.											
3.											
4.											

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin e ofertes ekonomike sipas shtojcës 1 dhe 2*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe merre përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019, 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në madhësinë fizike, kompleksitetin, metodat/teknologjinë dhe/ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- situacion punimesh
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh
- Akt kolaudimi;

2.3.2. OE duhet të dorëzojë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.P -	1	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P -	2	B	Ndertime civile dhe industriale
N.P -	3	A	Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash
N.P -	4	B	Rruge autostrada, ura, mbikalime, hekurudha
N.P -	12	B	Punime te inxhinerise se mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.S -	1	A	Punime per prishjen e ndertimeve
N.S -	2	A	Impiante hidro-termosantare dhe mirembajtja e tyre
N.S -	4	B	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese
N.S -	12	A	Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit
N.S -	14	A	Impiante te brendshme elektrike telefoni radiotelefoni TV
N.S -	18	A	Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1(nje) Inxhinier Ndertimi;

1(nje) Inxhinier Hidroteknik;

1(një) Inxhinier Mjedisi;me Certefikate VNM

1(një) Inxhinier Elektrik

1 (nje) Inxhinier Mekanik

1(nje) Inxhinier Topograf

1(nje) Inxhinier Gjeolog

1(nje) Arkitekt

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), me kontrat pune si më poshtë:

1(nje) Inxhinier Ndertimi profili Transport

1(nje) Inxhinier Mekatronik

1(nje) Inxhinier Elektronik

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 dhe 2.3.4, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV,
- Kontrat pune
- **Personeli kryesor, drejtues teknik** - të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Gusht -Nentor 2021.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr.8 Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kerkuar.**

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes si drejtues teknik i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës si drejtues teknik të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- 1 (një) punonjes të certifikuar si Ekspert zjarrefikes me certifikate perkatese.
- 1 (një) punonjes Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis me QKL i cili është gjithashtu edhe Përgjegjës për Problemet dhe Demet në Mjedis.
- 1 (një) punonjes si drejtues teknik të specializuar si Përgjegjës për sigurimin dhe Kontrollin e Cilesise sipas ISO 9001:2015
- 1 (një) punonjes si drejtues teknik të trajnuar si specialist “Për sistemet e Kontrollit dhe Komandimit”
- 1 (një) punonjes si drejtues teknik të trajnuar si specialist “Për përdorimin e pajisjeve të skanimit të strukturës për përcaktimin e sasisë së armatës pa shkaterim dhe Sklerometrit pajisje për përcaktimin e markës së betonit ”

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diploma/certifikata
- CV
- Kontrata e punës

2.3.5.1 Gjithashtu O E duhet të ketë të punësuar në stafin e tij personel të specializuar dhe të trajnuar nga institucione të certifikuara si më poshtë:

2(dy)Teknik Ndërtimi

2(dy)Hekurkthyes

1(nje)Teknik Elektronik

2(dy)Elektriste

2(dy)Hidraulike të certifikuar sipas EN 13067:2013

1(nje)Mekanik

1(nje) Elektroauto

2(dy)Karpantier

2(dy)Murator

2(dy)Pllakashtrues

2(dy)Hidroizolues

2(dy)specialist te sistemeve te kondicionimit

2(dy)montues tubash

2(dy)saldator

3(tre)suvatues

1(nje)specialist per montimin e kontruksineve metalike

1(nje)specialist nivelim betoni

4(kater)specialist bojaxhi

- -Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë, kontrate pune e vlefshme, deshmi aftesimi profesional leshuar nga institucione të certifikuar si dhe të jenë të përfshirë në Listëpagesen e shoqërisë sipas kategorisë përkatëse dhe kodit të punësimit për periudhën kohore sipas pikës 2.3.6

2.3.5.2. Gjithashtu O E duhet të ketë të punësuar në stafin e tij me kontratë pune :

- 1 (një) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë për të kryer auditime të Ndërtësive
- 1 (një) Auditues energjetik i Certifikuar Instalime industriale.

Për audituesit energjetik duhet të ketë këto dokumenta provues:

- Certifikata individuale, Kontrata e punës e vlefshme.

(Kushti i përcaktuar më sipër për auditues energjetik në Ndërtësive dhe auditues energjetik në instalime industriale mund të plotësohet dhe nga një auditues që i disponon të dyja certifikatat)

2.3.5.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar minimalisht:

- 5 (pese) punonjës mjeteve të rënda (Manovratore), të pajisur me Deshmi Aftësi Profesionale (te vlefshme) nga DPSHTRR, për të cilët duhet të paraqitet kontratë individuale e punës e vlefshme dhe Deshmi Aftësi Profesionale (e vlefshme), dhe të figurojë në listëpagesen e shoqërisë për muajin gusht 2021-nëntor 2021
- 4 (kater) shoferë, të pajisur me Certifikatë Aftësi Profesionale (te vlefshme) nga DPSHTRR, për të cilët duhet të paraqitet kontratë individuale e punës e vlefshme dhe Certifikatë Aftësi Profesionale (e vlefshme), dhe të figurojë në listëpagesen e shoqërisë për muajin gusht 2021-nëntor 2021
- 3 (tre) punonjës të çertifikuar për punime në lartësi (D.P.I. Rënia nga lartësitë ose ekuivalent) nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standartizimit kombëtar ose ndërkombëtar, nga të cilët 1 (një) të jenë inxhinier ndërtimi, dhe të figurojnë në listëpagesen e shoqërisë për muajin gusht 2021-nëntor 2021

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr.8 Ndërsa operatori ekonomik fitues, për lidhjen se kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar.**

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontratë duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 100 persona për periudhën gusht 2021-nëntor 2021 e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën gusht 2021-nentor 2021
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën gusht 2021-nentor 2021

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se AK të japë kontratën

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasi	Statusi
1	Eskavator me zinxhire	Cope	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
2	Eskavator me goma	Cope	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
3	Autogrejder	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
4	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
5	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10 - 18 ton	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
6	Kamionçinë (deri në 6 ton)	Cope	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
7	Gurëthyes, frontoje	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
8	Autobetoniere	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
9	Mjet autovinç	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
10	Fadrome Kove përpara dhe mbrapa	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
11	Pompe betoni	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
12	Pajisje për skanimin e struktura b/a për përcaktimin e sasisë së armaturës pa shkatërrim	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
13	Sklerometer, pajisje për përcaktimin e markës së betonit	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
14	Fabrikë asfalti	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
15	Autobitumatriçe	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
16	Asfalto-shtruese	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>

17	Rrul gome – hekur (kapaciteti jo me pak se 18 ton)	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
18	Rrul gome – hekur (kapaciteti jo me pak se 12 ton)	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
19	Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton)	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
20	Rrul asfalti me gome - gome (Kapaciteti jo me pak se 4 ton)	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
21	Autobot uji me sprucator	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
22	Freze asfalti me gjerësi deri 2 m	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
23	Vinc Kulle	Cope	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
24	Skeleri	m2	3000	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi</i>
25	Gjenerator	copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr.8 Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kerkuar.**

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- c) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.
- e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje si dhe në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme targa e mjetit.
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.8 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te cilesise (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- 27001-2013Çertifikate per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise se Informacionit (ISO 27001-2013) ose ekuivalente (e vlefshme).
- 45001-2018Çertifikate per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune (ISO 45001-2018) ose ekuivalente (e vlefshme).
- 3834-2:2006Çertifikate per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise ne Saldim(ISO 3834-2:2006) ose ekuivalente (e vlefshme).
- 1452-2:2006Çertifikate per Sistemin e Tubacioneve Plastike per furnizimin me uje,Kullimin dhe Kanalizimet nentokesore dhe Mbitokesore(ISO 1452-2:2006) ose ekuivalente (e vlefshme).
- 39001-2012Çertifikate per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Trafikun Rrugor (ISO 39001-2012) ose ekuivalente (e vlefshme)
- 50001:2011 Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te energjise (ISO 50001:2011) ose ekuivalente (e vlefshme).
- SA8000-2014- Çertifikate per sistemin e menaxhimit te pergjegjesise shoqerore ose ekuivalente (e vlefshme).

Te gjitha çertifikata e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.9.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese Kontrate furnizimi ne prani te noterit me prodhuesin/ distributorin e tubave (ujesjellesi dhe kanalizime) qe do te vendosen ne objekt, i shoqeruar me certifikate ISO 9001:2015 te prodhuesit te mallit, Autorizimin nga prodhuesi/distributori dhe katalogjet teknike te mallit te kerkuar. Ne rastet e paraqitjes se autorizimit ngadistributori, duhet te provohet lidhja ndermjet prodhuesit dhe distributorit te mallit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, certifikaten e mesiperme duhet ta paraqese anëtari grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit FVte referuar preventivit të objektit të prokurimit)

2.3.9.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese Kontrate furnizimi ne prani te noterit me prodhuesin/ distributorin e bojes qe do te vendoset ne objekt, i shoqeruar me certifikate ISO 9001:2015 te prodhuesit te mallit, Autorizimin nga prodhuesi/distributori dhe katalogjet teknike te mallit te kerkuar. Ne rastet e paraqitjes se autorizimit nga distributori, duhet te provohet lidhja ndermjet prodhuesit dhe distributorit te mallit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, certifikaten e mesiperme duhet ta paraqese anëtar i grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit FV të referuar preventivit të objektit të prokurimit).

2.3.9.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese Kontrate furnizimi ne prani te noterit meprodhuesin/distributorin e materialeve hidraulike qe do te vendoset ne objekt, ishoqeruar me certifikate ISO 9001:2015 te prodhuesit te mallit, Autorizimin ngaprodhuesi/distributori dhe katalogjet teknike te mallit te kerkuar. Ne rastet e paraqitjesse autorizimit nga distributori, duhet te provohet lidhja ndermjet prodhuesit dhedistributorit te mallit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, certifikaten e mesiperme duhet ta paraqese anëtar i grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit FV të referuar preventivit të objektit të prokurimit)

2.3.9.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese Kontrate furnizimi ne prani te noterit meprodhuesin/distributorin materialeve te duralimit qe do te vendoset ne objekt, ishoqeruar me certifikate ISO 9001:2015 te prodhuesit te mallit, Autorizimin ngaprodhuesi/distributori dhe katalogjet teknike te mallit te kerkuar. Ne rastet e paraqitjesse autorizimit nga distributori, duhet te provohet lidhja ndermjet prodhuesit dhedistributorit te mallit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, certifikaten e mesiperme duhet ta paraqese anëtar i grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit FV të referuar preventivit të objektit të prokurimit).

2.3.9.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese Kontrate furnizimi ne prani te noterit meprodhuesin/distributorin e pajisjeve te kondicionimit qe do te vendoset ne objekt, ishoqeruar me certifikate ISO 9001:2015 te prodhuesit te mallit, Autorizimin ngaprodhuesi/distributori dhe katalogjet teknike te mallit te kerkuar. Ne rastet e paraqitjesse autorizimit nga distributori, duhet te provohet lidhja ndermjet prodhuesit dhedistributorit te mallit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, certifikaten e mesiperme duhet ta paraqese anëtar i grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit FV të referuar preventivit të objektit të prokurimit).

2.3.9. 6 Operatori ekonomik duhet te paraqese Kontrate furnizimi ne prani te noterit meprodhuesin/distributorin e materialeve elektrike qe do te vendoset ne objekt, i shoqeruar me certifikate ISO 9001:2015 te prodhuesit te mallit, Autorizimin ngaprodhuesi/distributori dhe katalogjet teknike te mallit te kerkuar. Ne rastet e paraqitjesse autorizimit nga distributori, duhet te provohet lidhja ndermjet prodhuesit dhedistributorit te mallit.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet te paraqese Analize teknike sipas legjiislacionit miratuar me VKM nr. 629 datë 15.07.2015 te gjithë zerave te punes sipas preventivit bashkengjitur dokumentacionit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, certifikaten e mesiperme duhet ta paraqese anëtar i grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit FV të referuar preventivit të objektit të prokurimit).

-Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në

original ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

-Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe.

Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	_____
Numri NIPT/et:	_____
Adresa postare:	_____

Qyteti / qyteti; Kodi postar	
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjisllacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjisllacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentacit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]
etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.	
Operatori ekonomik nuk është dënuar me	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në

vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	
---	--

B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

--

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po []
